



Periodiku AMF

Zhvillohet seminari “Mbi sistemet e pensioneve private”

Më datë 9 shkurt 2009, Komisioni Evropian në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, brenda kuadrit të instrumentit TAIEX, zhvilloi seminarin "Mbi sistemet e pensioneve private" në ambientet e Hotel "Mondial" në Tiranë.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar 2009

Në muajin janar 2009, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 670,201 mijë lekë, përkundëjt 479,800 mijë lekë të realizuara në vitin 2008.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 39.68% nga viti i kaluar, ku 78.38% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 21.62% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 154.31% të sigurimeve të Jetës dhe 32.94% të sigurimeve të Jo Jetës.

Vijon në faqen 3

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të **tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë** për vitin 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” me 37.52% dhe vendin e dytë “Blerje në tregun primar” me 31.94% kundëjt volumit të përgjithshëm.

Vijon në faqen 4

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Mbi hartimin e tre projektligjeve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të punës së vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e bazës ligjore, ka hartuar së fundmi tre projektligje: **Projektligjin mbi fondet e pensionit vullnetar, projektligjin mbi obligacionet e shoqërive aksionere dhe qeverisë vendore, si dhe projektligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive**

Vijon në faqen 5

Edukimi i konsumatorit

Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve (Pjesë e shkëputur nga Botimi i IOPS: “Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve”)

Prezantim

I. Objektivat e mbikëqyrjes së pensioneve, përfshijnë mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe përfituesve të fondeve të pensioneve, duke ruajtur stabilitetin e industrisë së pensioneve dhe duke dhënë kontribut në stabilitetin e sistemit financiar në tërësi. Për të përmbushur këto objektiva, autoritetet mbikëqyrëse duhet të krijojnë metoda mbikëqyrëse, të cilat përfshijnë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme fondet e pensioneve, si nëpërmjet monitorimit dhe analizimit sistematik e nëpërmjet investigimeve më të thelluara, të cilat bëhen shpesh ose në baza të inspektimeve “në vend” (on – site basis).

Vijon në faqen 6

Në këtë numër:

Zhvillohet seminari “Mbi sistemet e pensioneve private” 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera 5

Edukimi i konsumatorit 9

Zhvillohet seminari "Mbi sistemet e pensioneve private"



Zj. E. Gjoni, Kryetare e AMF dhe përfaqësues të Autoriteteve Mbikëqyrëse homologe

Më datë 9 shkurt 2009, Komisioni Evropian në bashkëpunim e Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, brenda kuadrit të instrumentit TAIEX, zhvilloi seminarin "Mbi sistemet e pensioneve private" në ambientet e Hotel "Mondial" në Tiranë.

Ky seminar erdhi në një moment, kur Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është në procesin e hartimit të ligjit të ri në fushën e pensioneve private vullnetare, nën asistencën e Bankës Botërore. Ky ligj do t'i çelë hapësira të mëdha zhvillimit të sektorit të pensioneve private vullnetare, thënë ndryshe, kolonës së tretë, sipas parimeve dhe praktikave më të mira. Seminari u fokusua në promovimin e praktikave ndërkombëtare dhe shkëmbimit të eksperiencave midis rregullatorëve të ndryshëm nga Komuniteti Evropian. Vëmendje e veçantë iu kushtua mundësive të zhvillimit të këtij sektori, mbikëqyrjen efektive, nxitjen e skemës si alternativë afatgjatë kursimi, lehtësirat fiskale, si dhe mbrojtjen dhe edukimin e konsumatorit. Fjalën e hapjes e mbajti Kryetarja e AMF-së, Zj.



Stafi i AMF, përfaqësues të instituteve private të pensioneve, etj.

Elisabeta Gjoni, ku midis të tjerave prezantoi situatën aktuale në tregun e pensioneve private vullnetare dhe me gjerë, elementët e sistemit të pensioneve në Shqipëri, procesin e reformës, strukturën e draft ligjit për pensionet private vullnetare, skemën e pensioneve private, regjimin e licencimit dhe investimit për fondet e pensioneve, si dhe reformat ligjore në proces në këtë treg, i cili është ende në fazat e para të zhvillimit.

Në vijim, Z. Jiri Kral, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjare, prezantoi eksperiencat dhe reformat e ndërmarra në Çeki, me pensionet private. Z. Slawomir Solarz, Këshilltar në Departamentin e Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneve, pranë FSA, Poloni, bëri prezantimin mbi ndërtimin e sistemit të pensioneve me disa kolona në një vend me treg në zhvillim, si dhe eksperiencat e Polonisë nën këndvështrimin e kushteve të Shqipërisë dhe fushatën e ndërgjegjësimit të publikut si një element i reformës së pensioneve. Z. Guillaume Filhon, Drejtor i Kabinetit pranë CNAV, Francë, prezantoi qeverisjen e skemave të pensioneve në Francë.

Në seminar morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Institutet Private të Pensioneve, Dhoma e Tregtisë si dhe përfaqësues nga biznesi.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar 2009

Në muajin janar 2009, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 670,201 mijë lekë, përkundrajt 479,800 mijë lekë të realizuara në vitin 2008. Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 39.68% nga viti i kaluar, ku 78.38% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 21.62% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 154.31% të sigurimeve të Jetës dhe 32.94% të sigurimeve të Jo Jetës.

Në muajin janar 2009, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 11.94%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 81.78%.


Në muajin janar 2009 u lidhën 55,135 kontrata sigurimi, përkundrajt 42,173 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2008. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 51,792 nga 38,129 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli "Sigurimi i shëndetit" ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 12,865 kontrata ose në masën 66.52% më shumë se në janar 2008.

Vlen të përmendet ulja në masën 17.33% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 3,343 nga të cilat sigurimi "Jetë e kombinuar" ka një rritje prej 425 kontrata ose 590.28%, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar 2009 kapi vlerën 89,405 mijë

lekë, ose 1.16% më pak se në janar të vitit 2008. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 81,972 mijë lekë, apo 91.69% të totalit. Në portofolin "Kartoni Jeshil" kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 23.01% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 26.83% krahasuar me vitin 2008.

Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar 2009 (Jo Jeta)



Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar 2009 (Jeta dhe Jo Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar (2008 – 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2008	2009
Periudha janar		
A) Sigurim i Jetës	26,674	67,835
B) Sigurim i Jo Jetës	453,126	602,366
<i>nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	316,892	354,726
b) Sigurimi Vullnetar	136,234	247,640
TOTAL	479,800	670,201


Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” me 37.52% dhe vendin e dytë “Blerje në tregun primar” me 31.94% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2008 u dominua në masën 97.54% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 2.46% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve individëve apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individë me 98.18% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Letra me vlerë të Qeverisë për vitin 2008



Dy grupet e transaksioneve “B” dhe “C”

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2008, ka pësuar një ulje prej 176.82 milionë lekë ose 2.05% krahasuar me vitin 2007, ndërsa numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një ulje prej 12.73%.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë vitit 2008, ka pësuar një rritje prej 95.12 milionë lekë ose 18.19%

krahasuar me vitin 2007, ndërsa numri i transaksioneve të këtij lloji ka pësuar një rritje prej 16.39%.

Kjo ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007, kap vlerën 81.70 milion lekë ose 0.89%.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2007, 2008

Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar (2008 – 2009)

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2007	2008	08/07-1
Letra me vlerë të Qeverisë			
B.			
Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	8,634.71	8,457.89	(2.05)
Individë	8,419.70	6,693.88	(20.50)
Persona juridikë	215.01	1,764.00	720.43
C			
Blerje nga individët para afatit të maturimit	522.78	617.90	18.19
Individë	468.18	604.31	29.08
Persona juridikë	54.60	13.59	(75.12)

Ngjarje dhe zhvillime të tjera Mbi hartimin e tre projektligjeve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të punës së vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e bazës ligjore, ka hartuar së fundmi tre projektligje: **Projektligjin mbi fondet e pensionit vullnetar, projektligjin mbi obligacionet e shoqërive aksionere dhe qeverisë vendore, si dhe projektligjin**

për sipërmarrjet e investimeve kolektive

Hartimi i projektligjit “Mbi fondet e pensionit vullnetar”

Projektligji mbi fondet e pensionit vullnetarë u përgatit, me qëllim përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, vendosjen e standardeve të nevojshme për krijimin dhe administrimin e fondeve të pensionit vullnetar, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit, të nxitet

qëndrueshmëria, siguria dhe mirëqenia e aseteve të fondit të pensionit.

Projektligji i përgatitur ka synuar të përafrojë dhe në disa pjesë të tij të jetë në përputhje me direktivat/rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe me udhëzimet e OECD – IOPS, për licencimin e instituteve të pensionit suplementar vullnetar. Më konkretisht, projektligji mbi fondin e pensionit vullnetar është mbështetur në Udhëzimin 2003/41/EC “Për aktivitetin dhe mbikëqyrjen e instituteve të pensioneve profesionale”, Udhëzimin 85/611/EEC, Udhëzimin 72/166/EEC dhe Udhëzimin 2004/39/EC.

Ky projektligj është produkt i bashkëpunimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me ekspertë të Bankës Botërore, si dhe ka reflektuar në masë të konsiderueshme komentet dhe sugjerimet e ekspertëve të IOPS/OECD.

Përmbajta, qëllimi dhe konceptet e reja në këtë projektligj

- o Ky ligj do të rregullojë krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.
- o Qëllimi për të cilin është hartuar ky projektligj, është vendosja e standardeve të nevojshme për administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit, të nxitet qëndrueshmëria, siguria dhe mirëqeverisja e aseteve të fondit të pensionit.
- o Në kuptim të këtij projektligji, *fond pensioni është një grup asetesh*, i krijuar mbi bazë kontrate dhe *pa personalitet juridik*. Në projektligj rregullohen të gjitha procedurat e anëtarësimit, pezullimit të anëtarësimit, transferimit në një fond tjetër pensioni dhe tërheqjes nga fondi i pensionit.
- o Marrëdhënia midis kontribusve dhe shoqërisë administruese të fondit të pensionit është një

marrëdhënie kontraktuale, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Pjesë e rëndësishme është *kontrata e fondit të pensionit*, e cila lidhet midis shoqërisë administruese të fondit dhe anëtarëve që aderojnë në fond. Kontratës së fondit i bashkëlidhet *prospekti*, i cili është një dokument që përmban informacionin më të fundit në lidhje me fondin e pensionit. Kontrata e fondit të pensionit dhe prospekti me informacionin e nevojshëm miratohen nga autoriteti.

- o Në projektligj parashikohet forma ligjore (*shoqëri aksionare*), kërkesat për licencim dhe detyrimet e *shoqërisë administruese*, e cila do mbledhë dhe investojë fondet e pensioneve duke ruajtur interesin më të lartë të kontribusve.
- o Projektligji sjell një koncept të ri mbi kriteret që duhet të plotësojnë aksionaret dhe administratorët e shoqërisë administruese, duke parashikuar se ata duhet të jenë *të aftë dhe të përshtatshëm* për të marrë përsipër këto role. Projektligji ka dispozita të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit për këta persona gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në shoqërinë administruese. Në këtë mënyrë, ky projektligj, ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së këtyre personave, të cilët administrojnë kontributet për fondet e pensionit vullnetar.
- o Në projektligj parashikohen funksionet dhe detyrat e *depozitarit*, i cili në kuptim të këtij ligji është banka që licencohet nga autoriteti për të ofruar shërbime depozitimi në lidhje me asetet e fondit të pensionit. Sipas këtij projektligji, funksionet kryesore të depozitarit janë ruajtja e aseteve të fondit dhe garantimi i llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit. Depozitari licencohet nga autoriteti dhe ka detyrimin e raportimit tek ky i fundit.
- o Në projektligj parashikohet krijimi i *planit të*

pensionit profesional nga punëdhënësi për punonjësit e tij. Punëdhënësi merr përsipër krijimin e planit profesional për punëmarrësit e tij, duke lidhur një kontratë me shoqërinë administruese të fondit të pensionit. Punëdhënësi mund të marrë përsipër detyrimin për të paguar kontribute për planin e pensionit profesional, në emër dhe në favor të punëmarrësve të tij. Parashikimi i planeve profesionale të punëdhënësve ndaj punëmarrësve të tyre është shndërruar tashmë në një standard ndërkombëtar, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve.

- o Në projektligj janë parashikuar *politikat e investimit*, të cilat janë hartuar në përputhje me parimet e diversifikimit të riskut, duke pasur parasysh edhe mësimet nga kriza aktuale financiare botërore. Në këto dispozita, rëndësi u është kushtuar përcaktimit të klasave të investimeve të pa lejuara, duke shprehur në këtë mënyrë detyrimin e qartë të shoqërisë administruese për të mos investuar në instrumente financiarë, që nuk janë të listuar ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar ose në tregje të tjera të rregulluara nga autoritetet përkatëse.
- o Rëndësi në projektligj i jepet marketingut të fondit të pensionit në funksion të *mbrojtjes së konsumatorit*.
- o Në projektligj parashikohen *tarifat*, të cilat mund të aplikohen nga *shoqëria administruese*. Vendosen kufijtë maksimalë të lejuar për to.
- o Rëndësi i kushtohet *mbikëqyrjes* së fondeve të pensioneve ku sipas dispozitave të këtij projektligji, autoriteti ka një rol pro aktiv në mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve. Mbikëqyrja e fondeve do të përqendrohet në mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit, në përmirësimin e mirëqeverisjes, besueshmërisë dhe transparencës së fondit, duke u përqendruar

në çështje që paraqesin risk më të lartë. Në projektligj është trajtuar edhe shkëmbimi i informacionit me autoritete homologe dhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave.

- o Pjesa e mbikëqyrjes është hartuar në përputhje me parimet e mbikëqyrjes së pensioneve private sipas *udhëzimeve të IOPS* (Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrjes së Pensioneve), OECD dhe Bankës Botërore.
- o Në projektligj parashikohet e drejta e autoritetit për të vendosur *masa parandaluese dhe korigjuese* ndaj të gjithë të licencuarve. Këto dispozita rregullojnë gjithashtu vendosjen nën administrim të veçantë të të licencuarve, të drejtën e pezullimit të licencës ose revokimit të licencës, likuidimi dhe falimentimi i shoqërisë administruese. Këto dispozita janë hartuar në përputhje me eksperiencën ndërkombëtare dhe me legjislacionin shqiptar për falimentimin.
- o Në projektligj parashikohet *e drejta e ankimit* të të gjithë subjekteve, të cilët preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimet e autoritetit. Ligji i jep të drejtën e ankimit administrativ çdo subjekti, i cili pretendon se i është shkelur një e drejtë e ligjshme. Ky pjesë është hartuar sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.
- o Një risi e projektligjit është parashikimi i *lehtësirave tatimore*, me qëllim nxitjen e shtetasve shqiptarë për të kontribuar në fondet e pensionit vullnetar. Janë propozuar dy variante EEE dhe EET. Është Ministria e Financës që do të miratojë variantin përfundimtar.
- o Në projektligj parashikohen dispozita të caktuara në drejtim të *parandalimit të krimit financiar dhe pastrimit të parave*.
- o Në projektligj janë parashikuar *sanksionet*, në rastet kur shkelja e dispozitave të këtij

projektligji përbën vepër penale. Shkeljet e detyrimeve ligjore nga të licencuarit sipas këtij ligji do të përbëjë vepër penale dhe do të dënohet me gjobë ose burgim, kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda.

o Në projektligj parashikohen *tarifat e autoritetit* si ent rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të fondeve të pensioneve vullnetare.

o Në projektligj përfshihen edhe *dispozitat transitore* në të cilat parashikohet detyrimi i instituteve ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me Ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionin suplementar dhe institutet private të pensioneve" të paraqesin kërkesë për licencë brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në lidhje me sa më sipër, projektligji vendos standardet e nevojshme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar në përputhje me *direktivat e EU* dhe standardet e OECD – IOPS, duke krijuar kështu një bazë ligjore të përshtatshme për zhvillimin e kolonës së tretë të pensioneve në Shqipëri.

Hartimi i projektligjit “Mbi obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

Projektligji u hartua me qëllim që të sjellë një ndikim pozitiv në zhvillimin e tregut të titujve në Shqipëri.

Projektligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore” propozohet me qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ky projektligj u hartua edhe në kuadër të ndryshimeve që pësoi Legjislacioni Shqiptar, në lidhje me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara, Ligji “Për Titujt” dhe Ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me qëllim të arrihet përfshirja e projektligjit aktual në mënyrë harmonike me ligjet në fjalë.

Në përgjithësi, vlen të përmendim, se prezenca e një tregu të obligacioneve aktiv dhe eficient në Shqipëri, u ofron emetuesve një mënyrë alternative për të rritur kapitalin e huasë në rast kur bankat nuk kanë mundësi, duke ulur kështu efektin negativ që mund të shkaktojë një kolaps i kredive bankare në ekonominë Shqiptare. Gjithashtu, një treg obligacionesh i zhvilluar, ul riskun e huamarrësve, maturimin dhe mospërputhjen e valutës, ndërkohë që ofron vendosje çmimi në mënyrë eficiente për riskun e kreditit. Në fakt, një nga arsyet thelbësore për zhvillimin e tregut të obligacioneve, është krijimi tregjeve financiare më të kompletuara, duke gjeneruar norma interesi tregu, që reflektojnë koston oportune të fondeve në çdo maturim.

Projektligji “Mbi obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore” është mbështetur në Direktivën [2004/109/EC](#) “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për tu tregtuar në tregjet e rregullta” që amendon Direktivën [2001/34/EC](#), Direktivën [2003/71/EC](#) “Mbi publikimin e prospektusit kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për tu tregtuar” dhe Direktivën [2001/34/EC](#).

Hartimi i këtij projektligji u bë në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) dhe Firmën Ligjore Tsibanoulis & Partners.

Hartimi i projektligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Projektligji u hartua, duke marrë parasysh kërkesën në rritje të tregut për investime afatgjata si dhe faktin që pavarësisht se ka një ligj për fondet investimeve në fuqi, Ligji nr. 7979, datë 26 korrik 1995 “Për Fondet e Investimeve”, në praktikë nuk funksionon asnjë fond investimi kolektiv në Shqipëri. Për rrjedhojë, fondet e investimeve kolektive kërkojnë një rregullim ligjor

të mirë për t'i dhënë mundësi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare t'i zhvillojë dhe nxisë këto sipërmarrje të investimeve kolektive. Investitorët në këto fonde janë institucionet dhe gjithashtu individë e secili prej këtyre grupeve të interesit kanë nevojë për nxitje, për të marrë pjesë në skemat e fondeve kolektive.

Investitorët individë, zakonisht janë të prirur drejt investimeve afatshkurtër, ndërkohë që investitorët institucionalë zakonisht janë të prirur të jenë pjesë e strategjive të investimeve afatgjata në tregun e titujve, pra në bursë, duke ndihmuar kështu në krijimin e tregut të qëndrueshëm. Aktualisht, në Shqipëri, nuk ka institucione të investimit në titujt, përveç investimit në Bono Thesari, të cilat realizohen kryesisht nga bankat tregtare vendase. Vënia në zbatim e këtij projektligji do të krijojë pikërisht hapësirën e duhur për zhvillimin dhe rritjen e tregut të titujve.

Qëllimi i projektligjit është forcimi i sistemit të fondeve kolektive të investimit në Shqipëri, për të nxitur grupet e interesit që të përfshihen në skemat e fondeve kolektive të investimit. Ky projektligj propozohet në mbështetje të neneve 59, 78 dhe 81/1 të Kushtetutës.

Projektligji në fjalë është hartuar në përputhje me Direktivën që rregullon fondet e investimeve me Nr. 85/611/EEC, datë 20 dhjetor 1985 “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe parashikimeve administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive me tituj të transferueshëm”, e cila ka për qëllim harmonizimin e ligjeve, rregulloreve dhe parashikimeve administrative për sipërmarrjet e investimeve kolektive me tituj të transferueshëm.

Gjatë hartimit të tij janë marrë parasysh gjithashtu aktet ligjore në fushën e fondeve të investimeve të disa vendeve si Kroacia, Polonia dhe Maqedonia, duke u bazuar në mënyrën e transpozimit të direktivave përkatëse nga një shtet anëtar i BE siç është Polonia, si dhe nga një

shtet si Kroacia kandidate për anëtarësim, i përfshirë në të njëjtin proces stabilizim asociativ. Mbështetja në kuadrin ligjor të Kroacisë dhe Maqedonisë, ka pasur si qëllim edhe standardizimin e legjislacionit vendas me atë të vendeve fqinje, me problematika të ngjashme të tregjeve financiare.

Vlen të përmendet, se ky projektligj është produkt i bashkëpunimit me ekspertë të huaj të fushës, të cilët sollën përvojën e tyre të hartimit të ligjit, duke u nisur nga përvoja dhe tregje të kapitalit, të ngjashme me ato të vendit tonë. Gjithashtu, gjatë hartimit, janë zhvilluar takime dhe diskutime me grupet përkatëse të interesit, siç janë në veçanti përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit, bankave si dhe përfaqësues të biznesit në vend.

Edukimi i konsumatorit

Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve

(Pjesë e shkëputur nga Botimi i IOPS: 'Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve')

Prezantim

1. Objektivat e mbikëqyrjes së pensioneve, përfshijnë mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe përfituesve të fondeve të pensioneve, duke ruajtur stabilitetin e industrisë së pensioneve dhe duke dhënë kontribut në stabilitetin e sistemit financiar në tërësi. Për të përmbushur këto objektiva, autoritetet mbikëqyrëse duhet të krijojnë metoda mbikëqyrjeje, të cilat përfshijnë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme fondet e pensioneve, si nëpërmjet monitorimit dhe analizimit sistematik e nëpërmjet investigimeve më të thelluara, të cilat bëhen shpesh ose në baza të inspektimeve “në vend” (on – site basis).

2. Si rrjedhojë e rolit kryesor të sistemeve të fondeve të pensioneve në tregjet financiare dhe rëndësia e tyre në rritje, si një burim të ardhurë pensioni për individët, mbikëqyrja efektive e fondeve të pensioneve është duke u bërë gjithmonë e më e rëndësishme. Mbikëqyrja është duke luajtur një rol në rritje në sajë të kompleksitetit në rritje të sistemeve të pensioneve, të cilët si kundërpërgjigje ushtrojnë një presion në rritje në kostot dhe efikasitetin e mbikëqyrjes dhe drejt një tendence për një metodë mbikëqyrjeje bazuar në risk (risk - based supervisory approach).

3. Vlerësimi sistematik nëpërmjet monitorimit dhe analizimit është një mënyrë shumë e rëndësishme për të verifikuar ose marrë të dhëna dhe informacion të besueshëm, në mënyrë që të vlerësohet pozicioni financiar i fondit të pensioneve dhe aftësia e tij për të paguar të ardhurat e premtuara të pensionit tek përfituesit aktual ose atyre të ardhshëm. Monitorimi dhe analizimi është gjithashtu e një ndihme të madhe në krijimin e një profili risku për fondet e pensioneve, duke bërë të mundur lejimin e mbikëqyrësve të trajtojnë problemet e fondeve të pensioneve dhe të zbulojnë probleme/trende para se ato të bëhen statike, dhe mund të ndihmojnë të nxisin menaxhimin e riskut brenda vetë fondeve të pensioneve. Më tepër, duke bërë që fondet t'i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të kujdesshme nëpërmjet kërkesave për raportim mund të ketë një efekt shokues në vetvete.

4. Vlerësimi në brendësi i fondeve të pensioneve, qoftë kjo nga autoriteti mbikëqyrës ose përfaqësuesit e tij formalë, është në mënyrë të ngjashme një pjesë e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes dhe është ngushtësisht e lidhur me monitorimin e vazhdueshëm, duke siguruar informacion që plotëson analizimin e informacionit financiar dhe statistikor i dhënë autoritetit mbikëqyrës nga fondet e pensioneve. Këto investigime të thelluara mund të realizohen “në vend” p.sh, në zyrat e vetë

fondit të pensioneve. Inspektimi në vend lejon autoritetet mbikëqyrëse të krijojë gjykime më cilësore lidhur me funksionimin e fondit të pensioneve. Për shembull, a janë sistemet, të cilat duken të përshtatshme në letër, funksionojnë në praktikë? A tregon menaxhimi aftësi? A është eficient organizimi i fondit (që lejon për dokumente dhe të dhëna të cilat mund të aksesohen lehtësisht, etj.)?

5. Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve kanë nevojë të kenë një metodë mbikëqyrëse gjithëpërfshirëse dhe duhet të marrin në konsideratë duke përdorur të gjithë gamën e instrumenteve të mbikëqyrjes, në mënyrë që të veprojnë në mënyrën më eficiente dhe efektive të mundshme. Bilanci ndërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe investigimeve më të thelluara do të varet nga natyra e sistemit të pensionit dhe nga metoda e mbikëqyrjes. Për shembull, mbikëqyrësit në mënyrë të natyrshme do të besojnë më shumë në mbikëqyrjen off – site, në momentin kur ato funksionojnë duke mbikëqyrur disa mijë institucione pensionesh, të cilat nuk do të ishte e mundshme të vizitoheshin në baza periodike. Gjithsesi, nën këto kushte, mbikëqyrësit duhet të aplikojnë një metodë të bazuar në risk, kur vendosin se cilat institucione do të vizitohen dhe mbi shpeshësinë e këtyre inspektimeve në vend. Ndërkohë që janë të mundshme inspektimet në vend më të shpeshta, aty ku ka pak fonde për t'u mbikëqyrur dhe mund të jetë e domosdoshme aty ku autoriteti mbikëqyrës ka një mangësi mbikëqyrjeje direkte të institucioneve tregtare e ku sistemi përfshin kursime të detyrueshme. Investigime pak më të thella të fondeve mund të jenë të domosdoshme ku kujdestarët e aseteve ose palët e treta luajnë një rol aktiv “mbikëqyrës”, duke vepruar si whistle – blower (punonjës i cili raporton publikisht aktivitete ilegale të zhvilluara brenda në kompaninë e tij/saj) – ndonëse këto palë janë për vete subjekt i gabimeve të mbikëqyrjes.

6. Më shumë se të qenit një zgjedhje ndërmjet alternativave të veçanta, ekzistojnë një sërë instrumentesh të mbikëqyrjes, të cilët përfshijnë elemente të monitorimit dhe të analizimeve të rregullta dhe investigimeve më të thelluara. Për shembull, diskutime të rregullta me menaxhimin e fondeve të pensione mund të formojnë një pjesë të rëndësishme të procesit të mbikëqyrjes. Ajo çfarë është e rëndësishme, është që autoriteti mbikëqyrës ka një politikë koherente, të mirëmenduar për të vendosur mbi instrumentet e ndryshme të përvetësuar të mbikëqyrjes. Këto gjithashtu me kalimin e kohës do të ndryshojnë, për shembull disa autoritete mbikëqyrëse do të kalojnë drejt një mbikëqyrjeje të drejtuar më shumë drejt analizimit të dokumenteve (off-site supervision) me zhvillimin e sistemit të fondeve të tyre të pensione nga këndvështrimi i madhësisë dhe i sofistikimit të tyre, ndërkohë që të tjerë do të përdornin më shumë inspektimet në vend me zhvillimin e monitorimit dhe testeve të paralajmërimit paraprak dhe të sistemeve. Përsëri duhet të theksohet që shumëllojshmëria e instrumenteve dhe metoda e përdorur nga autoriteti mbikëqyrës, duhet të jetë proporcional me sasinë e riskut që fondi i paraqet anëtarëve dhe përfituesve të tij dhe nga sistemi i pensione në tërësi duhet të paraqesë përdorimin në mënyrën më eficiente të burimeve të mbikëqyrjes. Një gjë e rëndësishme, e cila duhet të merret në konsideratë, është evitimi i vendosjes së një detyrimi shumë të rëndë mbi institucionet e mbikëqyrura.

Qëllimi dhe mbulimi

7. Qëllimi i këtyre udhëzimeve, është që t'u sigurohet mbikëqyrësve të pensioneve, metoda të përgjithshme mbikëqyrëse për kryerjen e procesit të mbikëqyrjes. Duhet të theksohet që fokusi i këtyre udhëzimeve është kryesisht mbikëqyrje e kujdesshme. Disa referenca janë bërë lidhur me kryerjen e praktikave të

biznesit, por IOPS, mund të konsiderojë të zhvillojë udhëzime më të detajuara në këtë fushë në të ardhmen (veçanërisht për fondet e pensioneve të llojit të kontratës Kontribut i Përcaktuar). Udhëzimet janë menduar, me qëllim të mbulojnë të gjitha tipet e marrëveshjeve të pensioneve private, dhe megjithëse termi “fond pensionesh” është përdorur në dokument, disa prej udhëzimeve mund gjithashtu të aplikohen tek plani i pensionit, sipas të cilit vetë fondi është i strukturuar. Zbatimi i këtyre udhëzimeve do të ndryshojë nga vendi në vend duke u varur nga natyra e sistemit të pensioneve dhe struktura e mbikëqyrjes. Autoritetet Mbikëqyrëse të Pensioneve, të referuara në dokument, janë të përkufizuara si një institucion, përgjegjëse totalisht ose pjesërisht për mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve, planeve, skemave ose marrëveshjeve në një vend ose në sektor të një vendi, qoftë e investuar me personalitetin vetjak ose jo.

Udhëzimet janë të hartuara nga “Parimet e Mbikëqyrjes së Pensioneve Private” të IOPS, “Parimet Kryesore të Rregullave të Pensioneve Profesionale” të OECD (në veçanti me Parimin Kryesor 6 mbi Mbikëqyrjen), udhëzimeve të tjera të OECD të lidhura me pensionet, Parimi Kryesor 12, të IAIS “Raportimi tek Mbikëqyrësit dhe Monitorimi nëpërmjet analizës dokumentare”, Parimi Kryesor 13 “Inspektimi Në - Vend”, si dhe projekte të tjera të IOPS (duke përfshirë punën mbi mbikëqyrjen me bazë risku dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit). Dokumenti është i strukturuar si vijon;

Parathënie – përshkrim i objektivave të mbikëqyrjes

Procesi i Mbikëqyrjes – i ndarë në tre pjesë:

- **Monitorimi:** Në të cilën përshkruhen kontrollat të një natyre të zakonshme.
- **Analiza:** Përshkruhen se si të indentifikohen probleme potenciale.
- **Investigime më të thelluara:** Përmbledhje të investigimeve të bëra për institucione të

përzgjedhura.

- **Organizimi:** Vendos theksin mbi faktorët të cilët sigurojnë një përdorim eficient të burimeve të mbikëqyrjes.

Parathënie

Objektivi i Monitorimit Sistemik të Fondeve të Pensioneve

Objektivi i mbledhjes dhe analizimit në mënyrë sistematike të informacionit, i cili lidhet në mënyrë specifike me fondet e pensioneve, është që tu mundësojë autoriteteve të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve, të monitorojnë dhe vlerësojnë profilin e riskut të fondeve të pensioneve dhe të planifikojnë metodën e tyre mbikëqyrëse.

8. Qëllimi kryesor i vlerësimit në mënyrë sistematike i fondeve të pensioneve është të përcaktohet profili i riskut i një fondi dhe të planifikohet një reagim i përshtatshëm nga mbikëqyrësi. Mbledhja dhe analizimi në mënyrë sistematike e informacionit do të ndihmojë autoritetin mbikëqyrës në identifikimin e risqeve në kohë (duke krahasuar profilin e riskut të fondit me aftësinë e tij për të marrë përsipër risk), për të monitoruar përputhshmërinë në mënyrë sistematike dhe për të identifikuar çdo problem, i cili mund të ndikojë në aftësinë e fondit për të plotësuar detyrimet e tij afatgjata drejt anëtarëve dhe përfituesve, ose të vendosë në rast se është i nevojshëm analizimi i informacioneve shtesë.

9. Monitorimi dhe analizimi sistematik, mund tu shërbejnë disa ose të gjithë funksioneve të mëposhtme të përgjithshme, duke u varur nga konteksti në të cilin autoriteti mbikëqyrës është duke funksionuar.

- a. Vlerësimi i pozicionit të fondit të pensionit lidhur me kategoritë kryesore të riskut, si në terma të fuqisë financiare dhe risqeve të tjera të paraqitur anëtarëve dhe përfituesve të fondit (siç janë risku i investimit, risku i jetëgjatësisë, risku operacional, risku i

agjencisë dhe risku sistematik).

- b. Verifikimi i informacionit i paraqitur nga fondet e pensioneve gjatë procesit të licencimit ose regjistrimit dhe verifikimi i informacionit siguruar mbi baza të vazhdueshme (p.sh opinioni i auditit).
- c. Kontrolli i përputhshmërisë i fondeve të pensioneve me kërkesat ligjore, të kujdesshme, siç janë rregullat e financimit ose limitet e investimeve dhe me ligjet e tjera sociale e të punës aty ku është e përshtatshme.
- d. Plotëson dhe rrit informacionin publik (siç janë audituesit, etj.) i disponueshëm mbi fondet e pensioneve.
- e. Kontroll i vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve (të cilat duhet të jenë të qëndrueshme, reale dhe të vlerësuara me kujdes).
- f. Kontrollimi i sistemeve të menaxhimit të riskut, të përdorura tek fondi i pensioneve dhe si rrjedhim dhe kontroll i aftësisë së fondit për të mbajtur risqet e mësipërme.
- g. Të sigurojë që anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensioneve është duke ju siguruar informacion i mjaftueshëm dhe që fondi është duke funksionuar në një mënyrë të përshtatshme e transparente.
- h. Të indentifikojë problemet, veçanërisht në intervalin ndërmjet inspektimeve të thelluara, duke siguruar kështu një ekspozim praparak dhe duke ndërmarrë në kohë veprime korrigjuese përpara se problemet të bëhen më serioze. Vlerësime sistematike gjithashtu mund të sigurojnë baza për diskutime me bordin/menaxherët e fondit të pensioneve, si dhe në intervale periodike ashtu dhe kur shfaqet problemi.
- i. Të sigurojë një element themelor të planifikimit të mbikëqyrjes në mënyrë që të merret përfitimi maksimal brenda kohës së kufizuar të shpenzuar për kryerjen e një inspektimi më të thelluar.
- j. Gjenerimi i statistikave dhe monitorimi i tendencave, niveleve të mbrojtjes së konsumatorëve dhe konkurrencës në sistemin e pensioneve në tërësi (i cili gjithashtu mund

të përdoret për tu koordinuar me mbikëqyrësit e sektorëve të tjerë financiarë).

- k. Mbledhja e informacionit, i cili gjithashtu kërkohet nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, kur më shumë se një institucion ka përgjegjësi mbikëqyrëse, duke evituar duplikimin dhe duke siguruar përputhshmëri dhe përdorimin e përbashkët të informacionit.

Objektiva të Vlerësimeve më të Thelluara

Objektivi kryesor i vlerësimeve më të thelluara, është të plotësojë përpjekjet e vazhdueshme të mbikëqyrjes, të identifikojë problemet që ndryshe nuk mund të jenë evidente dhe të konfirmojë ose investigojë konkluzione nga programet sistematike të monitorimit.

10. Qëllimi i investigimeve më shumë të thelluara, të cilat mund të realizohen në vend në intervale të caktuara ose siç kërkohet, është të mundësojë që autoriteti mbikëqyrës të marrë informacion më të thelluar për situatën brenda institucionit të mbikëqyrur, të marrë informacion dhe të indentifikojë probleme të cilat nuk mund të merren ose zbulohen nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm.
11. Përsëri duke u varur nga konteksti, një investigim i thelluar mund t'i japë mbikëqyrësve mundësinë të realizojnë disa nga objektivat e mëposhtëm:
- a. Ai i jep autoritetit mbikëqyrës mundësinë për të identifikuar çdo problem për të cilin fondit nuk është në dijeni për, ose lëkundet për ta marrë parasysh, ose mbase edhe ta fshehtë (duke përfshirë dhe identifikimin e problemeve të cilat mund të shfaqen nga organizimi i fondit të pensioneve). Nëse problemet janë identifikuar, kjo bën të mundur që mbikëqyrësi të sigurojë më shumë të dhëna për të konfirmuar ekzistencën dhe/ose shtrirjen e këtij problemi.
- b. Më shumë se sa të qenit të kufizuar në indentifikimin e problemeve të fondit, investigimet më të thelluara i lejojnë

- mbikëqyrësit të rrëmojnë për arsyet prapa tyre, t'i kërkojë fondit të pensioneve për identifikimin e zgjidhjeve për t'i kapërcyer ato në mënyrë që të inkurajojë në praktikën më të mira për përballimin e risqeve të shfaqura.
- c. Ai i ofron mbikëqyrësve mundësinë për të pasur një marrëdhënie më të ngushtë me menaxherët e fondit të pensioneve, e cila mund të bëhet e rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë dhe përputhshmërisë së tyre.
- d. Ai i mundëson mbikëqyrësve për të vlerësuar proceset e vendim marrjes së menaxhimit, të kontroleve të brendshme (duke përfshirë menaxhimin e riskut dhe sistemet e TI, sistemet e kontabilitetit dhe raportimit, etj.), dhe të formojë një opinion mbi qeverisjen e fondit në praktikë se sa në letër.
- e. Ai bën të mundur të bindë menaxhimin e fondit të pensioneve për të ndërmarrë veprime për të evituar problemet aktuale ose të ardhshme, nëpërmjet dialogut gjatë procesit të investigimeve më të thelluara (të cilat mund të jenë më efikente se sa nëpërmjet veprimeve formale siç janë rregullat ose instruksionet), ose edhe t'i kthejë mendjen atyre nga ushtrimi i aktiviteteve, të cilat janë gjithashtu ilegale ose jo të rregullta.
- f. Ai i siguron mbikëqyrësve mundësinë për të shpjeguar rregullat ose udhëzimet specifike (për të evituar keqinterpretimin ose të nxisë praktika të mira), për të analizuar ndikimin e rregullave të tilla dhe, më në përgjithësi, për të mbledhur informacion për qëllime krahasimore.

Procesi i mbikëqyrjes

Udhëzimi 1 : Mbledhje dhe Përdorimi i Përbashkët i Informacionit

Autoriteti i mbikëqyrjes së pensioneve duhet të marrë informacionin e nevojshëm për të realizuar një vlerësim efektiv, për të përcaktuar risqet në fondet individuale të pensioneve, si dhe gjithashtu të tregut në tërësi, megjithatë duhet të hartohet një politikë për

mbrojtjen e informacionit konfidencial.

Aty ku informacioni është i një rëndësie materiale në nivel ndërkombëtar, ai duhet të bashkëpërdoret me autoritetet e tjera të mbikëqyrjes së pensioneve, subjekt i kërkesave të fshehtësisë ose konfidencialitetit dhe në parim të bazuara mbi marrëveshje formale.

në parim janë të bazuara mbi marrëveshje formale. Shkëmbime të tilla informacioni do t'i nënshtrohen kërkesave të sekretit dhe konfidencialitetit.

Vijon në numrin tjetër...

I. Monitorimi

1.1 Procedura kryesore në vlerësimin sistematik të fondeve të pensioneve është mbledhja e informacionit të mjaftueshëm për të krijuar një profil rishikimi të fondeve, të cilat mbikëqyren për të vlerësuar zbulimin ndaj risqeve potenciale dhe të mbledhë të dhëna e statistika rreth sektorit në tërësi. Informacioni mund të mbledhet mbi baza sistematike ose jo sistematike (publikisht të disponueshme dhe informacion plotësues) mbi procedurat e fondeve të pensioneve, mekanizmave të qeverisjes, transaksioneve, pozicionit financiar, etj. Informacioni i mbledhur duhet të përdoret për të drejtuar veprimet e mbikëqyrës dhe mund gjithashtu të rritë transparencën e fondit të pensioneve.

1.2 Në rastin kur informacioni i kërkuar është i një natyre konfidenciale, duhet të vihet në dispozicion informacioni, se si ai do të përdoret dhe kujt prej palëve të tjera do t'i jepet (nëse ka të tillë). Nëse legjislacioni nuk e mbulon këtë në mënyrë të përshtatshme, atëherë autoriteti mbikëqyrës duhet të publikojë një politikë për këtë gjë.

1.3 Në rastin kur informacioni mund të ketë peshë të konsiderueshme në operacionet në/ose stabilitetin e tregjeve ndërkombëtare të pensioneve, duhet të ndërmerren hapa për shkëmbimin e informacionit ndërmjet mbikëqyrësve të vendeve të ndryshme, të cilat

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, E. Sherri, L. Lloji,
R. Eltari, E. Zalta, E. Kokona

